

**VLERËSIMI I NDIKIMIT TË  
NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË TË  
DREJTAT E FËMIJËVE NË SHQIPËRI**

**RAPORT VLERËSIMI**

*Tiranë, 2022*

## Tabela e përmbajtjes

Listë shkurtesash.....	1
1. <i>Hyrje</i> .....	3
2. <i>Metodologjia dhe objektivat</i> .....	8
2.1 Kuptimi i Vlerësimit të Ndikimit të të Drejtave të Fëmijës.....	101
3. VNDF lidhur me ndryshimet klimatike .....	11
4. Legjislacioni në fushën e ndryshimeve klimatike në Shqipëri .....	12
a. <i>Kuadri i përgjithshëm</i> .....	12
b. <i>“Deklarata për Veprim mbi Fëmijët, të Rinjtë dhe Klimën”</i> .....	14
c. <i>Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve (2022-2027)</i> .....	15
d. <i>Traktati për Krijimin e Komunitetit të Energjisë</i> .....	15
e. <i>Ligj nr.155/2020, “Për ndryshimet klimatike”</i> .....	16
5. Perceptimet e grupeve të interesit për ndikimin e ndryshimeve klimatike tek fëmijët.....	18
I. <i>Njohuritë për ndryshimet klimatike dhe rëndësia e tyre</i> .....	20
II. <i>Njohuritë për ligjin për ndryshimet klimatike</i> .....	21
III. <i>Aktivitetet që organizohen nga fëmijët dhe të rinjtë për ndryshimet klimatike</i> .....	21
IV. <i>Pritshmëritë nga aktorët e tjerë</i> .....	22
6. VNDF lidhur me ndryshimet klimatike në Shqipëri.....	23
Struktura e VNDF .....	24
7. Gjetjet dhe Rekomandimet .....	34
8. Bibliografia .....	389
ANEKS .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>



AVOKATI I POPULLIT



## Listë shkurtesash

<b>AKM</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
<b>AP</b>	Avokati i Popullit
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>ENNHRI</b>	European Network of National Human Rights Institutions
<b>GES</b>	Gazet me Efekt Serë
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>KDF</b>	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
<b>KE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>MASR</b>	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
<b>MRV</b>	Monitorim, Raportim, Verifikim
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>SC</b>	Save the Children
<b>VNDF</b>	Vlerësimi i Ndikimit të të Drejtave të Fëmijëve, (Child Rights Impact Assessment)

## 1. Hyrje

Këshilli për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara në 8 tetor 2021, për herë të parë me *Rezolutën 48/13*, vendosi të përfshinte të drejtën e njeriut për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm. Kjo rezolutë njeh dhe pranon, ndryshimet klimatike si një faktor thelbësor që ndikon në gëzimin e kësaj të drejte dhe ndërkohë dëmtimi i mjedisit sjell pasoja negative të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta në gëzimin efektiv të të gjitha të drejtave të njeriut.<sup>1</sup> Ky hap thelbësor, edhe pse i vonuar është një kthesë e rëndësishme në vëmendjen që në kuadër të OKB-së, por edhe të organizatave të tjera ndërkombëtare ka marrë çështja e mjedisit në përgjithësi dhe ajo e ndryshimeve klimatike në veçanti.

Ky ndryshim në qasjen ndaj mjedisit dhe në ndërgjegjësimin për trajtimin e mbrojtjes së tij si një çështje që ka nevojë të menjëhershme për veprim, është rezultat i shumë viteve aktivizmi të organizatave të shoqërisë civile, por edhe të grupeve të interesit. Ajo që vitet e fundit ka ndikuar më së shumti në këtë drejtim është aktivizmi i të rinjve dhe i fëmijëve në këtë fushë. Që prej 2009, OJQ-të e të rinjve janë pranuar prej Konventës Kuadër të OKB-së mbi ndryshimet klimatike.<sup>2</sup> Ky aktivizëm është përshkallëzuar me fushata ndërgjegjësimi dhe protesta të shumta, përgjithësisht të organizuara nën drejtimin e vetë të rinjve, prej nga kanë spikatur dhe personazhe interesante si Greta Thunberg, që shërbejnë si modele frymëzimi për fushata globale veprimi. Nuk kanë munguar as veprime konkrete ligjore, duke adresuar çështjet përpara institucioneve administrative dhe gjyqësore ndërkombëtare.

Menjëherë pas zjarreve shkatërruese të vitit 2017 në Portugali, katër fëmijë dhe dy të rinj nga zona e goditur nga zjarri, paditën 33 shtete anëtare të Këshillit të Evropës, përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me pretendimin se nuk kishin bërë mjaftueshëm për të luftuar krizën klimatike. Ata argumentuan se këto vende po dështojnë në marrjen e masave të duhura për të

---

<sup>1</sup>Rezolutën e plotë mund ta gjeni në:

<https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G21/289/50/PDF/G2128950.pdf?OpenElement>

<sup>2</sup>*Youth and Climate Change*, OKB, dokumenti i plotë, në:

<https://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-climatechange.pdf>.

mbajtur nivelin e rritjes, së ngrohjes globale nën 1.5°C, që të përmbushin detyrimet e tyre ligjore në kuadër të Marrëveshjes së Parisit. Sa më sipër, ata argumentuan se kërcënohet e drejta e tyre për të jetuar, si dhe e drejta për një mjedis të mbrojtur dhe të shëndetshëm, të garantuar nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).<sup>3</sup> Ky është rasti i parë që GJEDNJ merr në shqyrtim në fushën e ndryshimeve klimatike, por sigurisht që nuk pritet të jetë i fundit. Organizata Save the Children ka ndërhyrë zyrtarisht në cilësinë e personit të tretë në këtë proces, në mbështetje të argumenteve të paraqitura nga kërkuesit përpara gjykatës. Ky status i jep mundësi organizatës që të japë qendrimin e saj përpara gjykatës, duke dhënë pikëpamjet e saj përpara Gjykatës, lidhur me ndikimet që ndryshimet klimatike kanë mbi fëmijët dhe të drejtat e tyre për një të ardhme të sigurtë dhe të begatë. Organizata të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, si ENNHRI<sup>4</sup> kanë ndërmarrë aksione konkrete gjyqësore, duke u bërë palë në procese të rëndësishme pranë gjykatave ndërkombëtare, në fushën e ndryshimeve klimatike.<sup>5</sup> Jurisprudenca e GJEDNJ thekson vazhdimisht nevojën e marrjes së masave thelbësisht efektive të institucioneve lidhur me identifikimin, ndryshimin dhe përmirësimin e politikave dhe aspekteve të përshtatshme në fushën e ndryshimeve klimatike.

Ndryshimet klimatike po marrin një vëmendje të shtuar duke marrë përparësi në vendimarrjet politike të shteteve, megjithëse ende jo në nivelin e duhur. Asnjë politikë ndaj ndryshimeve klimatike nuk është e plotë dhe nuk mund të jetë efektive, nëse nuk merr në konsideratë ndikimet që do të ketë tek të drejtat e fëmijëve, si një shtresë e shoqërisë që ka nevojë të shtuar për mbrojtje sot dhe si përfaqësues të brezit të ardhshëm, që më së shumti do të vuajnë kostot e ndryshimeve

---

<sup>3</sup> Më shumë lidhur me këtë çështje në: <https://www.savethechildren.net/news/save-children-intervenues-climate-change-court-case-brought-young-people-against-33-countries>; Parashtrimet me shkrim për aplikimin si palë e tretë nga Save the Children International, <https://www.savethechildren.net/sites/www.savethechildren.net/files/Application%20No.%2039371-20%20-%20Third%20party%20written%20observations%20by%20Save%20the%20Children%20International%20-%20205%20May%202021%282006746.1%29.pdf>.

<sup>4</sup> ENNHRI – European Network of National Human Rights Institutions, Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut.

<sup>5</sup> ENNHRI ka paraqitur një ndërhyrje si palë e tretë përpara GJEDNJ, në çështjen për ndryshimet klimatike *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerë kr. Zvicrës*. Parashtrimet e ENNHRI theksojnë përgjegjësinë e shteteve për të luftuar ndryshimet klimatike efektivisht; Parashtrimet e plota me shkrim: <https://ennhri.org/wp-content/uploads/2021/09/Third-Party-Intervention-Klimaseniorinnen-website.pdf>.

klimatike. UNICEF vlerëson se mbi 99% e fëmijëve, janë aktualisht të ekspozuar ndaj të paktën një prej rreziqeve, goditjeve dhe streseve të mësipërme klimatike dhe mjedisore.<sup>6</sup>

Kuadri ligjor në fushën e ndryshimeve klimatike në nivel ndërkombëtar, por edhe vendor, është i ri dhe ende në hapat e parë. Shqipëria për shumë kohë i është shmangur ndërmarrjes së politikave në kuadër të ndryshimeve klimatike, të cilat nuk kanë marrë një vëmendje të veçantë si në aspektin e legjislacionit përkatës, të politikave afatgjata apo afatmesme qeverisëse, por edhe në kuadër të organizatave mjedisore.<sup>7</sup> Kjo ka ndodhur për disa arsye, por mund të përmendim si më të rëndësishmet problemet e thella ekonomike me të cilat vendi është përballur pas ndryshimit të sistemit, probleme që sigurisht marrin përparësi kundrejt çështjeve të mjedisit në përgjithësi dhe ndryshimeve klimatike në veçanti. Së dyti, ka qenë e rëndësishme për vendin që të zgjohej ndërgjegjësimi mjedisor, të arrihej edukimi dhe përfshirja sa më e madhe në çështjet mjedisore në tërësi, për të kaluar pastaj edhe në aspekte të veçanta të tyre, siç janë edhe ndryshimet klimatike. Së treti, Shqipëria duke qenë një vend i vogël shpesh herë konsiderohet me një ndikim minimal në panoramën e gjerë të ndryshimeve klimatike, por sigurisht që ky nuk përbën më një argument të vlefshëm, përse kohë jemi ndër vendet ku ndryshimet klimatike po ndihen me mjaft intensitet. Strategjia e fundit për zhvillimin e qëndrueshëm përcakton si një ndër rezultatet e pritshme të saj, pikërisht rritjen ekonomike të qëndrueshme, që nuk dëmton mjedisin, e siguruar përmes një stabiliteti makroekonomik në rritje, një mjedisi biznesi më konkurrues dhe novator dhe përdorimit më të qëndrueshëm të burimeve.<sup>8</sup>

Politikat ndërkombëtare dhe ato evropiane llojnë fuqishëm për faktin se çështjet e ndryshimeve klimatike janë tjetër aspekt nga çështjet mjedisore e si rrjedhojë, politikat lidhur me to nuk mund të jenë të njëjta. Republika e Shqipërisë ka një qasje mjaft të hapur ndaj normave të së drejtës ndërkombëtare dhe këtu nuk bëjnë përjashtim as marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve si dhe të ndryshimeve klimatike. Shqipëria ashtu si çdo shtet

---

<sup>6</sup> *The Climate Crisis is a Child Rights Crisis: Introducing the Children's Climate Risk Index*. New York: United Nations Children's Fund (UNICEF), 2021.

<sup>7</sup> KAS, "Raport i Fondacionit KAS për klimën në Shqipëri", 2011.

<sup>8</sup> VKM Nr.348, dt.11.05.2016, "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020".

tjetër anëtar i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, ka detyrimin që të respektojë, të mbrojë dhe të përmbushë të drejtat e fëmijëve të garantuara nga kjo Konventë.

Avokati i Popullit është institucion i ngarkuar nga ligji për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj.<sup>9</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri, e ka në fokus të veçantë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve është një nga pesë seksionet e këtij institucioni. Ndër të tjera, ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ka parashikuar në pikën 7, të nenit 34 se: “Avokati i Popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”. Ky aspekt është vlerësuar dhe në raportin e fundit të Agjencisë Evropiane për të Drejtat Themelore (FRA).<sup>10</sup> Në ushtrim të këtyre kompetencave, për të adresuar sfidat që rrjedhin nga problemet e ndryshimeve klimatike, jo vetëm në këndvështrim të gjendjes aktuale, por mbi të gjitha si një e drejtë e pamohueshme e fëmijëve dhe të rinjve, Avokati i Popullit, duke synuar që çështjet e mjedisit të aktualizohen si të lidhura ngushtësisht me të drejtat e fëmijëve, konferencën vjetore të vitit 2021 e ka zhvilluar me temën: “Të Drejtat e Brezave të Ardhshëm dhe Ndryshimet Klimatike”<sup>11</sup>

Neni 4 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve,<sup>12</sup> parashikon detyrimin e shteteve anëtare që të angazhohen dhe të marrin të gjitha masat legjislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Është pikërisht kjo dispozitë që u sjell detyrimin shteteve që në miratimin e çdo akti juridik, ligjor apo nënligjor të bëjnë një vlerësim që ky akt ka mbi të drejtat e fëmijëve. Legjislacioni shqiptar nuk e ka të rregulluar në mënyrë të posaçme një vlerësim të tillë të fokusuar vetëm në të drejtat e fëmijëve, por kërkon një vlerësim të përgjithshëm

---

<sup>9</sup> Neni 2 dhe 31, ligji 8454, dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”.

<sup>10</sup> FRA, *NHRI Accreditation Status*, qershor 2022, [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2022-NHRI-update\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2022-NHRI-update_en.pdf).

<sup>11</sup> Më shumë informacion gjeni në: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/home/news/this-article-is-available-only-in-albanian-739/>.

<sup>12</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin: Nr.7531, datë 11.12.1991.

të ndikimit që ka akti i ri që miratohet.<sup>13</sup> Si praktikë VNDF janë një mjet i vlerësimit paraprak, gjatë fazës së hartimit të aktit ligjor ose nënligjor, me qëllim vlerësimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe dhënien e rekomandimeve të nevojshme, nëse ka nevojë për ndryshime në draftin e propozuar. Megjithatë, është i njohur edhe raporti *ex-post factum*, me qëllim evidentimin e përputhshmërisë së legjislacionit përkatës kuadër në raport me detyrimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe të ndikimeve të pritshme negative apo pozitive të aktit ligjor, politikës, apo masës konkrete të propozuar.

Mbështetur në parashikimet ligjore, dokumenti do të vlerësojë dhe analizojë ndikimin që kanë politikatat në fushën e mbrojtjes klimatike mbi fëmijët, qoftë në këndvështrimin mbi ndikimin që ka mbi jetën dhe shëndetin e fëmijëve, por edhe nga perspektiva e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse dhe konsultuese. Synimi i këtij vlerësimi është që të drejtat e fëmijëve të marrin përparësi në kuadër të shumëllojshmërisë së interesave që ndikohen nga ndryshimet klimatike dhe aktet e reja juridike, të udhëhiqen duke marrë parasysh të gjitha të drejtat e parashikuara nga Konventa, madje duke përfshirë edhe pikëpamjet e vetë fëmijëve. Ajo që një raport VNDF arrin dhe përfitimi kryesor që vjen prej hartimit të tij, është ndërgjegjësimi i politikëbërësve, vendimmarrësve, por edhe ligjzbatuesve për mundësitë që ky mjet ofron për përmirësimin e politikave që adresojnë çështjet e fëmijëve. Sa më sipër mundëson që të kalohet nga një model vlerësimi përputhshmërie, në një mjet të mirëfilltë të zhvillimit të politikave që mund të çojë përpara zbatimin e parashikimeve të KDF-së përmes realizimit progresiv të të drejtave të fëmijëve.<sup>14</sup>

Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve thekson se për të siguruar një qeverisje të mirë në kuadër të respektimit të të drejtave të fëmijëve, VNDF duhet të bëhet sa më parë pjesë e proceseve qeverisëse, në të gjitha nivelet, në procesin e hartimit të akteve ligjore, por edhe të miratimit të politikave dhe strategjive. Metodologjitë mbi të cilat mund të mbështetet kjo përfshirje janë të shumëllojeshme, por ajo që duhet të jetë thelbësore është përfshirja e KDF si kornizë juridike. Në veçanti, vlerësimet duhet të mbështeten nga parimet e përgjithshme të KDF-së dhe të bazohen në

---

<sup>13</sup> Shiko VKM nr.584, dt.28.08.2003, “Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave” (i ndryshuar).

<sup>14</sup> “*Child Rights Impact Assessment (CRIA): A review of comparative practice across the UK*”, Unicef UK, Lisa Payne, qershor 2017.



të dhënat e fëmijëve dhe palëve të tjera të interesuara.<sup>15</sup> Zbatimi efektiv i KDF-së është thelbësor për garantimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, si një konsideratë parësore për të gjitha veprimet dhe vendimet që ndikojnë në mirërritjen dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen, duke qenë se ndryshimet klimatike përbëjnë sot një kërcënim të madh që i prek ata jo vetëm gjatë fëmijërisë, por edhe në moshën madhore. Sot një fëmijë që është 10-vjeç, në vitin 2030 do të ketë hyrë në moshë madhore.

## ***2. Metodologjia dhe objektivat***

Dokumenti për Vlerësimin e Ndikimit, në parim ka si objekt vlerësimin e ndikimeve të pritshme të një projekt akti ligjor, apo ndikimeve që ky akt ka pas miratimit, për aspekte të caktuara që janë në fokus të dokumentit. Raporti konkret, si një Vlerësim i Ndikimit mbi të Drejtat e Fëmijëve në vend në fushën e ndryshimeve klimatike, është ndërtuar mbi struktura të dokumenteve të ngjashme të hartuara nga OKB-ja, UNICEF, Save the Children, apo shtete anëtare të BE-së.

Raporti do të vlerësojë nëse legjislacioni kuadër në fushën e ndryshimeve klimatike në vend, ka arritur që të trajtojë në mënyrën e duhur, ndikimet që ndryshimet klimatike kanë, apo pritet që të kenë, mbi të drejtat e fëmijëve dhe të të rinjve, sipas përcaktimit që ju bëhet këtyre të drejtave në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Raporti do të nxjerrë në pah të drejtat përkatëse të fëmijëve që ndikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga ndryshimet klimatike, duke identifikuar grupet e fëmijëve që do të preken veçanërisht dhe si arrin legjislacioni shqiptar në këtë fushë t'i trajtojë këto çështje. Do të propozohen rekomandime lidhur me zbutjen e ndikimeve në ato fusha, ku legjislacioni nuk ka arritur që të garantojë trajtimin në frymën e duhur të të drejtave të fëmijëve që preken nga ndryshimet klimatike.

---

<sup>15</sup>Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, Komenti i Përgjithshëm nr.14, *Mbi të drejtën e fëmijës që interesat e tij më të mira të merren si konsideratë parësore*, neni 3, pg.1, OKB.

Të dhënat e mbledhura nga palët përkatëse të interesit dhe grupet e fokusit, janë bërë pjesë e rezultateve të raportit. Raporti është hartuar duke pasur parasysh se është e rëndësishme jo vetëm të vlerësohet kuadri ligjor në fuqi, por është thelbësore që të konsiderohen në mënyrë specifike të drejtat e fëmijëve, kur merren vendime politike. Raporti ju rekomandon fuqishëm politikëbërësve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në vendimmarrjen e lidhur me ndryshimet klimatike, që në adresimin e çështjeve, është e nevojshme dhe e domosdoshme që t`ju kushtohet vëmendje edhe të drejtave të fëmijëve dhe mundësisë për garantimin e tyre në këtë kuadër juridik kaq specifik, siç është ai që parashikon mbrojtjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke mësuar nga praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Korniza e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit kombinon kërkimin empirik me atë studimor. Të dhënat e përdorura për hartimin e vlerësimit kanë përfshirë të dhëna cilësore dhe sasiore. Të dhënat cilësore janë mbledhur përmes intervistave dhe analizës së dokumenteve. Analiza sasiore mbështetet në të dhënat dytësore të mbledhura nga planet, dokumentet, raportet dhe analizat e raporteve të shumta të organizatave dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e ndryshimeve klimatike me fokus tek fëmijët.

Vlerësimi i Ndikimit të të Drejtave të Fëmijëve për Ndryshimet Klimatike dhe trajtimi që kuadri ligjor në vend ju ka bërë këtyre ndikimeve, përfshin tre faza: *faza e parë*, përfshin zhvillimin e planit të kërkimit, rishikimin e literaturës, hartimin e instrumenteve kërkimore; *faza e dytë*, ju kushtua mbledhjes së të dhënave, ku përfshihen si të dhënat për ndryshimet klimatike në vend, zhvillimet më të fundit në kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe të dhënave nga aktorët e përfshirë në proces veçanërisht qëndrimet dhe perceptimet e fëmijëve; analiza e të dhënave dhe shkrimi i raportit vlerësues merr vend në *fazën e tretë*.

Raporti ndërtohet në dy shtylla kryesore sa i përket fokusit dhe objektivave që kërkon të arrijë:

1. Dimensioni ligjor duke evidentuar specifikisht kornizën ligjore për ndryshimet klimatike në vendin tonë dhe qasjen që ky kuadër ka kundrejt të drejtave të fëmijëve në vend, specifikisht ato të garantuara nga KDF;

2. Qasjen institucionale të adresuar nga ligji, me vëmendje të veçantë në rolin dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit në këtë fushë.

Krahas evidentimit të qasjes ligjore dhe asaj institucionale në kontestin shqiptar, janë përdorur për sa ka qenë e arsyeshme dhe e mundur disa dokumente strategjike evropian.

### ***2.1 Kuptimi i Vlerësimit të Ndikimit të Drejtave të Fëmijës***

Në këtë pjesë do të trajtohet mekanizmi i vlerësimit të të drejtave të fëmijës si një mekanizëm për matjen e ndikimit pozitiv apo negativ si dhe perceptimin e fëmijëve në raport me çështjet klimatike. Lidhur me këtë pjesë, është vijuar në të njëjtën rrugë të ndjekur dhe nga eksperiencat e mëparshme të ngritura nga Save the Children International dhe Save the Children Albania. Prezantimi i këtij dimension, në pikëpamjen e kontekstit ndërkombëtar dhe atij evropian do të shpërfaqë edhe aspektin shqiptar, duke evidentuar kështu trajtën që ka marrë VNDF në vendin tonë.

VNDF shqyrton ndikimet e mundshme mbi fëmijët dhe të rinjtë të ligjeve, politikave, vendimeve buxhetore, programeve dhe shërbimeve ndërsa ato janë duke u zhvilluar dhe nëse është e nevojshme, sugjeron mënyra për të shmangur ose zbutur çdo ndikim negativ.<sup>16</sup> Si rregull, ky dokument hartohet përpara miratimit të vendimit apo veprimit, megjithatë nuk përjashtohen rastet kur vlerësimi për aktin juridik dhe ndikimet e tij në të drejtat e fëmijëve, bëhet pas miratimit të tij. Në këtë rast, VNDF mund të propozojë se çfarë ndryshimesh do të nevojiten për të siguruar që akti juridik në fjalë të respektojë të drejtat e fëmijëve dhe të jetë në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, protokollet e saj opsionale dhe traktate të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Përdorimi i VNDF-së mbështet një vlerësim dhe komunikim sistematik të ndikimit të një propozimi ose mase mbi të drejtat, nevojat dhe interesat e fëmijëve dhe të rinjve. Nevoja për të

---

<sup>16</sup> Ky përkufizim është marrë nga ENOC European NetWork of Ombudspersons for Children [http://enoc.eu/?page\\_id=3718](http://enoc.eu/?page_id=3718), parë së fundmi në Maj 2022.

futur një proces të vazhdueshëm të VNDF-së, është rekomanduar nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve në disa nga komentet e tij të përgjithshme. Në Komentin e tij të Përgjithshëm Nr.5 (2003), mbi Masat e Përgjithshme të Zbatimit, ky organizëm lidhur me VNDF-në shprehet: *“Sigurimi që interesat më të mira të fëmijës të jenë konsiderata kryesore në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët (neni 3 (1)), dhe që të gjitha dispozitat e Konventës të respektohen në legjislacionin dhe zhvillimin dhe zbatimin e politikave në të gjitha nivelet e qeverisjes, kërkon një proces të vazhdueshëm të vlerësimit të ndikimit tek fëmijët (duke parashikuar ndikimin e çdo ligji të propozuar, politikë ose ndarje buxhetore që prek fëmijët dhe gëzimin e të drejtave të tyre) dhe vlerësim të ndikimit tek fëmijët (duke vlerësuar ndikimin aktual të zbatimit)”* (pg.45).

### 3. VNDF lidhur me ndryshimet klimatike

Qeveritë kanë përgjegjësi madhore për miratimin e politikave që i përgjigjen ndryshimeve klimatike. Megjithatë, qeveritë në vendet në zhvillim kanë më pak gjasa të përfaqësojnë interesat e fëmijëve në mënyrë efektive, duke i lënë fëmijët në rrezik edhe më të madh të pasojave të dëmshme.<sup>17</sup> Rritja e vazhdueshme e vëmendjes kundrejt ndryshimeve klimatike edhe në kuptim të ndikimeve që ato kanë tek fëmijët, është shoqëruar domosdoshmërisht me një sërë Udhëzuesish dhe Manualesh, të cilat synojnë të përcaktojnë ndikimin që ndryshimet klimatike kanë në nivel global dhe rajonal, apo hartimin e Modeleve që mund të përdoren edhe në zona të tjera. Krahas modeleve të ndryshme të marra në shqyrim për strukturimin e këtij raporti, pozitë të veçantë mbajnë dy dokumente të hartuara nga Save the Children (*Born to Climate Crisis* dhe *Child Rights Impact Assessment SC*), të cilët kanë rëndësi jo vetëm për formën, por edhe përmbajtjen, pasi janë të lidhur me fushën specifike të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Rëndësia e tyre për efekt të këtij raporti lidhet në veçanti me:

---

<sup>17</sup> Janet Currie and Olivier Deschênes, Children and Climate Change: Introducing the Issue”, *Children and Climate Change, The future of Children*, Vol.26, Nr.1, 2016.

1. Rëndësinë e VNDF për ndryshimet klimatike.
2. Veprimtarinë ndërkombëtare dhe atë evropiane lidhur me këtë kontekst.
3. Evidentimin e dokumentave ndërkombëtare dhe evropiane.

Referimi në dokumentat ndërkombëtare, nuk ka për synim që të thellohet në analiza të hollësishme juridike apo të nivelit politik, por do t'i serviret këtij raporti vetëm për efekt të vendosjes së kontekstit shqiptar në këtë mjedis.

#### **4. Legjislacioni në fushën e ndryshimeve klimatike në Shqipëri**

##### *a. Kuadri i përgjithshëm*

Republika e Shqipërisë është palë në të gjitha aktet e miratuara në kuadër të OKB-së në këtë fushë, por edhe në një sërë marrëveshjesh të tjera ndërkombëtare, të cilat kërkojnë nga vendi marrjen përsipër të detyrimeve në fushën e ndryshimeve klimatike. Raporti nuk ka synim të vlerësojë kuadrin juridik ndërkombëtar përkatës, duke qenë se tashmë ka mjaft studime ezauruese, por do të evidentojë disa prej akteve juridike kryesore ndërkombëtare dhe detyrimet që adresohen për Shqipërinë në fushën e ndryshimeve klimatike.

Mjedisi i shëndetshëm dhe ekologjikisht i përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm përbën një prej objektivave socialë që shteti shqiptar synon të arrijë referuar parashikimeve të Kushtetutës së vendit.<sup>18</sup> Ndërkohë në seksionin e lirive dhe të drejtave, në kuadër të mjedisit, Kushtetuta njih vetëm të drejtën për t'u informuar për mjedisin dhe gjendjen e tij.<sup>19</sup> Përpara vitit 2020, Shqipëria ka miratuar disa akte nënligjore të cilat synojnë uljen e ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike, marrjen e masave për të ulur emetimet e gazrave serë nga veprimtaritë e ndryshme njerëzore, si dhe masa të tjera, me fokus përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të vendit. Megjithatë, do të ishte ligji 155/2020, i cili do të krijonte kornizën ligjore përkatëse, në referencë

---

<sup>18</sup> Neni 59, 1(d) i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<sup>19</sup> Neni 56 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

edhe të legjislacionit të Bashkimit Evropian në këtë fushë. Për këtë arsye fokusi kryesor i kësaj pike, do të jetë pikërisht analiza e këtij ligji dhe për sa është e mundur evidentimi dhe analiza e legjislacionit dytësor në vendin tonë lidhur me këtë fushë.

*Tabela 1* përmban një listë të akteve juridike kryesore të cilët kanë një ndikim në fushën e ndryshimeve klimatike, apo të të drejtave të fëmijëve. Për efekt të lidhjes së drejtpërdrejtë dhe të specifikës që ka, në vijim do të ndalemi shkurtimisht në parashikimet kryesore të disa prej tyre, duke përfshirë ndër të tjera edhe Traktatin për Krijimin e Komunitetit të Energjisë, si dhe ligjin 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”.

1	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin: Nr.7531, datë 11.12.1991
3	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, miratuar në Nju Jork më 9 maj 1992, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 1995 dhe ku Republika e Shqipërisë është palë jo e shtojcës I
4	“Konventa e Aarhusit”, ose “Konventa për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, Ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000
5	“Protokolli i Kiotos i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike”, miratuar në Kioto më 11 dhjetor 1997, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 30 qershor 2005
6	“Deklarata për Veprim mbi Fëmijët, të Rinjtë dhe Klimën”, Deklaratë Ndërqeveritare e OKB-së, Madrid 2019

7	Rezolutat 37/8, 35/20 and 40/11 të Këshillit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së
8	Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve (2022-2027), “Të drejtat e fëmijëve në veprim: nga zbatimi i vazhdueshëm tek inovacioni i përbashkët”
9	“Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”, ratifikuar me ligjin nr.9590, dt.27.07.2006
10	Traktati për Krijimin e Komunitetit të Energjisë, Ratifikuar me ligjin Nr.9501, dt.03.04.2006
11	Ligji 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”
12	Ligj nr.155/2020, “Për ndryshimet klimatike”

Tabela 1, Lista e Akteve Juridike në fushën e ndryshimeve klimatike në Shqipëri

*b. “Deklarata për Veprim mbi Fëmijët, të Rinjtë dhe Klimën”, Deklaratë Ndërqeveritare e OKB-së, Madrid 2019*

Kjo Deklaratë përfaqëson një seri angazhimesh të shteteve për të marrë në konsideratë vazhdimisht nevojat, të drejtat dhe perspektivat specifike të fëmijëve në politikat dhe veprimet e tyre klimatike në të gjitha nivelet. Ky kuadër gjithëpërfshirës synon t’i përgjigjet faktit që kriza klimatike është një krizë e të drejtave të fëmijëve, duke njohur gjithashtu kapacitetin e madh të fëmijëve dhe të rinjve, për të qenë agjentë të fuqishëm të ndryshimit. Ai gjithashtu kërkon të adresojë mospërfshirjen e përhapur të fëmijëve nga politikat, strategjitë dhe planet e klimës. Referuar kësaj Deklarate është thelbësore që fëmijët të vendosen në zemër të veprimit klimatik dhe të investohet në zgjidhje praktike për mbrojtjen e fëmijëve nga efektet e ndryshimeve klimatike. Kjo Deklaratë ka si objektivi që jetë një mjet transformues në raport me aftësinë e shteteve për të garantuar të

drejtat e fëmijëve në kuadër të Marrëveshjes së Parisit dhe Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm të OKB-së.<sup>20</sup>

*c. Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve (2022-2027), “Të drejtat e fëmijëve në veprim: nga zbatimi i vazhdueshëm tek inovacioni i përbashkët”<sup>21</sup>*

Në këtë dokument, mjedisi dhe ndryshimet klimatike kanë marrë një vëmendje të veçantë. Strategjia e re e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës 2022-2027 ka parashikuar si fushën e gjashtë prioritare të drejtat e fëmijëve në situata krize dhe emergjence, për të mbuluar çështje të tilla si aksesimi në një mjedis të shëndetshëm dhe marrja e veprimeve për të luftuar ndryshimet klimatike, të drejtën për mbrojtje në zonat e konfliktit, migrimin ose zhvendosjen e detyruar ose ndikimin e një krize të shëndetit publik në të drejtat e fëmijës. Ndërkohë në listën e sfidave janë përfshirë: ndryshimet klimatike, degradimi i mjedisit, zhvendosja e detyruar, migrimi dhe konfliktet po shkaktojnë gjithashtu pabarazi dhe varfëri të fëmijët.

Konstatohet se ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë natyrore po pengojnë aftësinë e fëmijës për të shijuar një mjedis të shëndetshëm dhe degradimi i mjedisit është i lidhur me probleme të rënda shëndetësore për fëmijët. Fëmijët janë gjithashtu shumë të ekspozuar ndaj toksicitetit.

*d. Traktati për Krijimin e Komunitetit të Energjisë, Ratifikuar me ligjin Nr.9501, dt.03.04.2006*

Komuniteti i Energjisë është një organizatë ndërkombëtare, në të cilën anëtarë janë Bashkimi Evropian, Shqipëria dhe 8 vende të tjera të Evropës Lindore. Objektivi i kësaj organizate është të shtrijë rregullat, standardet dhe parimet e tregut të brendshëm të energjisë së BE-së, tek shtetet anëtare.<sup>22</sup> Kjo synohet të arrihet ndër të tjera, duke zbatuar nga shtetet anëtare *acquis-n* e BE në fushën e energjisë, mjedisit, ndryshimeve klimatike, konkurrencës dhe burimeve të rinovueshme. Traktati parashikon që pas hyrjes në fuqi të tij, ndërtimi dhe realizimi i projekteve të reja në secilin

<sup>20</sup> Deklaratën e plotë e gjeni në: <https://www.unicef.org/environment-and-climate-change/climate-declaration#faq>

<sup>21</sup> Teksti i plotë i strategjisë: [https://search.coe.int/cm/pages/result\\_details.aspx?objectid=0900001680a5a064\\_mbledhja\\_e\\_1426<sup>te</sup>.23 shkurt 2022.](https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectid=0900001680a5a064_mbledhja_e_1426%26_23_shkurt_2022)

<sup>22</sup> Shih <https://www.energy-community.org/>.



vend, duhet patjetër të jetë në përputhje me *acquis-n* e BE-së. KE monitoron progresin e bërë nga vendet anëtare dhe referuar raportit të fundit, rezulton se Shqipëria<sup>23</sup> nuk i ka përmbushur ende detyrimet e saj në raport me *acquis*.

Ky traktat ka një rëndësi specifike, pasi e vendos vendin përpara një detyrimi konkret dhe pozitiv për të zbatuar kuadrin juridik të Bashkimit Evropian edhe në fushën e ndryshimeve klimatike, pavarësisht transpozimit apo jo të normave në legjislacionin e brendshëm.

*e. Ligj nr.155/2020, “Për ndryshimet klimatike”*

Republika e Shqipërisë si një vend anëtar i Konventës Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, i Traktatit të Energjisë si dhe i angazhimeve në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ka ndër të tjera edhe detyrimin që të marrë masat e nevojshme për të kontribuar në uljen e efekteve të ngrohjes globale. Një ndër hapat më të rëndësishëm në këtë drejtim ishte miratimi i ligjit të parë kuadër për ndryshimet klimatike, konkretisht i ligjit 155/2020. Ky akt përveç përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, ka përafuar legjislacionin shqiptar në këtë fushë me *acquis-n* e BE-së, si dhe ka krijuar kuadrin ligjor mbështetës për shumë akte të tjera nënligjore në fushën e ndryshimeve klimatike, që duhet të miratohen në vijim, për të transpozuar direktiva e rregullore të tjera të BE-së në këtë fushë.<sup>24</sup> Ligji është miratuar gjatë periudhës së pandemisë, por ai i është nënshtruar procesit të konsultimit publik në përputhje me ligjin 164/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” gjatë vitit 2017.

Objektivi kryesor i ligjit për ndryshimet klimatike është krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional gjithëpërfshirës, për të kontribuar në uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serë dhe në përshpejtimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, duke kontribuar në përpjekjet globale në këtë fushë.

Përpara miratimit të këtij ligji në vend mungonte një përcaktim i saktë dhe shterues ligjor, lidhur me atë se çfarë përbëjnë “*efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike*”, edhe pse një koncept i

---

<sup>23</sup> *Annual Implementation Report, Energy Community Secretariat, November 2021.*

<sup>24</sup> Relacion për projektligjin “Për ndryshimet klimatike”,  
<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190830110704RELACION%20-%20NDRYSHIMET%20KLIMATIKE.pdf>

trajtuar gjerësisht. *“Efekte të dëmshme të ndryshimeve klimatike” janë ndryshimet në mjedisin fizik apo biotë që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, të cilat kanë efekte të rëndësishme negative mbi përbërjen, aftësinë vetëpërtëritëse, produktivitetin e ekosistemeve natyrore apo të menaxhuara, funksionimin e sistemeve social-ekonomike apo mbi shëndetin dhe mirëqenien e njeriut e të kafshëve blegtorale, si: gjedh, të imta, derra dhe njëthundrakë.”*

Ligji ka listuar se cilët janë objektivat kombëtarë për ndryshimet klimatike, me qëllim dhënien e kontributit në këtë sfidë globale, duke listuar ndër të tjera: zvogëlimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serë; rritjen e aftësisë për t’u përshtatur ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike; diversifikimin ekonomik dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore etj..

Përmbushja e kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore që do të dalin në zbatim të tij, është lënë nën monitorimin e një grupi ndërministror, detyrë e cila duhet të kryhet çdo katër vjet. Ligji krahas përfshirjes së kushteve të reja për miratimin e një lejeje mjedisore, kushte të cilat tashmë duhet të marrin në konsideratë edhe elementët për uljen e nivelit të shkarkimit të gazrave serë, ka parashikuar edhe detyrimin për monitorim të subjekteve ekzistuese dhe dorëzimin e tij më pas pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Referuar ligjit për lejet mjedisore dhe për mbrojtjen e mjedisit, autoriteti që do të ketë kompetencë mbikqyrjen e shkarkimit të gazrave është autoriteti inspektues përkatës.<sup>25</sup>

Ligji parashikon detyrime në kuadër të uljes së emetimeve të gazeve serë, edhe për automjetet e reja, për avionët dhe anijet, si dhe marrjen e masave në fushën e pyjeve e të bujqësisë, duke synuar reduktimin e shkarkimeve dhe përthithjen e karbonit nga sektorët e bujqësisë, të pyjeve, përdorimeve të tjera të tokës dhe ruajtjes së ekosistemeve. Në vend do të ngrihet sistemi MRV (monitorim, raportim dhe verifikim), me synimin për të rritur transparencën për përpjekjet që bëhen për zbutjen e ndryshimeve klimatike, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.

Krahas masave konkrete teknike, ligji parashikon dhe masa për rritjen e edukimit qytetar dhe arsimor, nëpërmjet përfshirjes së programeve të posaçme në sistemin arsimor, si dhe marrjen e

---

<sup>25</sup>Aktualisht inspektimi i ndikimit në mjedis dhe i respektimit të Lejes Mjedisore, Deklaratës Mjedisore, apo Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, kryhet nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

masave për të realizuar informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, nëpërmjet fushatave të informimit për të sensibilizuar e ndërgjegjësuar popullatën për efektet negative të ndryshimeve klimatike, për masat konkrete që mund të marrin për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Si një ligj që kërkon bashkëpunimin e gjerë dhe mbështetjen e publikut, sigurisht që pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje është pjesë e rëndësishme e procesit. Ligji e parashikon si një detyrim konkret, por rregullimin e lë në kompetencë të akteve specifike ligjore në këtë fushë.

Duke e konsideruar zhvillimin e qëndrueshëm si një zgjidhje afatgjatë për problemin e ndryshimeve klimatike, ligji kërkon nga institucionet vendimmarrëse ndërmarrjen e politikave konkrete për nxitjen e sektorit publik dhe privat, për investime të konsiderueshme që shkarkojnë pak gazra serë, janë transparente, kanë rezultate të parashikueshme dhe inkurajojnë ndërmarrjet, institucionet, grupet sociale dhe individët për të ndjekur dhe për t'iu përshtatur progresit dhe inovacionit teknologjik, zbatimit të rezultateve të shkencës e teknologjisë, zhvillimit të arsimit dhe industrisë, në zbatim të kërkesave të këtij ligji.

Për shkak të elementëve kompleks që parashikon arritja e objektivave të përcaktuara në këtë ligj, periudha tranzitore për plotësimin me akte nënligjore është mjaft e gjatë, katër vjet dhe një pjesë e akteve nënligjore që tashmë janë miratuar më parë, janë lënë ende në fuqi. Edhe pse të ndodhur në këtë terren 'pothuajse të vakët legjislativ' në vendin tonë, institucionet publike duhet të nxisin aktivisht lobimin për nisjen e politikave dhe masave konkrete për çështjet klimatike. Në strategjinë e veprimtarisë për vitin 2020 të Ombudsmanit Evropian '*emergjenca klimatike*' është evidentuar si një ndër sfidat kryesore me të cilat BE duhet të përballet.<sup>26</sup>

## **5. Perceptimet e grupeve të interesit lidhur me ndikimet e ndryshimeve klimatike tek fëmijët**

---

<sup>26</sup> Shih elementë nga Strategjia e Ombudsmanit Evropian (2020) <https://www.ombudsman.europa.eu/en/our-strategy/home/en>.

Ky seksion do të prezantojë gjetjet e marra nga realizimi i pyetësorëve dhe fokus grupeve të zhvilluara në kuadër të këtij raporti. Një nga aspektet pozitive të VNDF është mundësia që ky mjet vlerësimi ofron për t'i afruar fëmijët me procesin e vendimmarrjes publike,<sup>27</sup> si një e drejtë e tyre dhe një detyrim për autoritetet vendimmarrëse. Në këtë seksion do të paraqiten pyetësorët, intervistat dhe fokus grupet, duke pasqyruar aktorët e përfshirë. Paraqitja e përgjigjeve do të bëhet në mënyrë narrative dhe të përmbledhur, duke mos ndjekur në mënyrë mekanike ecurinë e pyetjeve të pyetësorit.

Në datat 28 dhe 29 Prill me fëmijë dhe të rinj të shkollave 9-vjeçare dhe gjimnazeve të qytetit të Durrësit dhe Elbasanit u zhvilluan fokus grupe në platformën elektronike zoom. Diskutimi zgjati rreth një orë e tridhjetë minuta me secilin grup. Fëmijët dhe të rinjtë i përkisnin klasave të 7<sup>ta</sup>, 8<sup>ta</sup> dhe të 9<sup>ta</sup> dhe përgjithësisht reflektonin aktivizime të mëparshme me Zërin 16+, të mbështetur nga Save the Children Albania. Fokus grupi me fëmijët dhe të rinjtë në qytetin e Elbasanit u organizua me 22 fëmijë (15 femra dhe 7 meshkuj), kurse në qytetin e Durrësit me 15 fëmijë (9 femra dhe 6 meshkuj). Paraprakisht, në bashkëpunim me koordinatorët lehtësues u vendos në dispozicion pyetësori dhe konteksti i përgjithshëm i qëllimit të projektit, por edhe i studimit në fjalë. Fëmijët dhe të rinjtë, gjatë takimit në Zoom u njohën me aspekte organizative, mbrojtje të të dhënave personale, qëllimet e fokus grupit, si dhe një kontekst të përgjithshëm të situatës legjislativë në vendin tonë lidhur me ndryshimet klimatike. Thjeshtësia e servirjes së pyetjeve dhe lehtësimi gjatë diskutimit, duke e përshtatur situatën në nivelin e njohurive të tyre u mbajt në konsideratë gjatë zhvillimit të takimeve. Pyetjet u hartuan në tre aspekte kryesore për të marrë perceptimin e fëmijëve dhe të rinjve referuar:

1. Njohurive të përgjithshme të çështjeve të ndryshimeve klimatike.
2. Njohuritë e të rinjve për aspekte legjislativë për ndryshimet klimatike.
3. Pritshmëritë e fëmijëve dhe të rinjve për iniciativat institucionale dhe rolin e tyre në parandalimin dhe zgjidhjen e situatave që lidhen me ndryshimet klimatike.

---

<sup>27</sup> Unicef (2010), *Child rights toolkit* – draft version. Vol.1.

Perceptimet e fëmijëve dhe të rinjve lidhur me këtë çështje, rezultuan të reflektonin një interesim të lartë dhe lidhje të ngushtë mes tyre dhe kauzës në fjalë. Aktivizimi i tyre në nivel idesh dhe praktik rezultoi të ishte një motivim premtues, për përcjelljen e rëndësisë së ndryshimeve klimatike në vendin tonë si dhe në përditshmërinë e tyre.

### ***I. Njohuritë për ndryshimet klimatike dhe rëndësia e tyre***

Fëmijët dhe të rinjtë pohuan në tërësi se ata kanë informacion lidhur me ndryshimet klimatike, jo vetëm si një koncept në morinë e informacionit, por mbi të gjitha për rëndësinë që po merr kohët e sotme në jetën e gjithësecilit. Mosdiferencimi i stinëve, ndotja e lumenjve, mungesa e ajrit të pastër në përditshmëri, ishin disa prej aspekteve që fëmijët veçuan si të lidhura me ndryshimet klimatike. Pjesëmarrësit pohuan që një pjesë të konsiderushme të informacioneve që zotëronin në këtë fushë, e kishin në sajë të pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme të organizuar nga shkolla, por më së shumti nga Zëri 16+.

Edhe pse fëmijët shprehën që në disa raste nuk ishin të orientuar specifikisht drejt kësaj kauze, vlerësuan rëndësinë e aktivizimit për të parandaluar apo zgjidhur çështje që lidhen me ndryshimet klimatike si një domosdoshmëri të madhe. Ky perceptim rezultoi të ishte i unifikuar në të dy fokus grupet e zhvilluara.

Fëmijët kishin njohuri për modele ndërkombëtare në fushën e ndryshimeve klimatike, siç është rasti i `fenomenit` Greta Thunberg, një aktiviste adoleshente për mbrojtjen e klimës nga Suedia, e cila në vitin 2018, ishte nismëtare e protestave të nxënësve të shkollave në Suedi, të cilët nuk ndoqën procesin mësimor për të protestuar kundër ndryshimeve klimatike. Në sajë të veprimtarisë së saj, Greta u bë e njohur në mbarë botën duke marrë pjesë dhe në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Raste të tilla motivuese duhet t'i shërbejnë edhe deklaratave të fuqishme në terrenin shqiptar. Deri më sot, në shumë aktivizime të ndryshme, ende nuk kemi një deklaratë publike e në nivel masiv të ndonjë fëmije apo të riu në vend, i cili të mund të marrë përsipër rolin e një modeli kombëtar. Ky aspekt, edhe pse shkon përtej edukimit ligjor, mbart në

vetvete elementë të konsiderueshëm të tij të vlefshëm për t'u theksuar në opinionin publik, pasi vlerësohet se rrit ndjeshëm ndërgjegjësimin dhe afrimin e të rinjve ndaj kësaj kauze.

## ***II. Njohuritë për ligjin për ndryshimet klimatike***

Fëmijët dhe të rinjtë e qytetit të Durrësit nuk kishin njohuri se një ligj specifik ishte miratuar për ndryshimet klimatike. Ndërkohë, ata u shprehën se kishin dëgjuar për disa masa për mbetjet plastike, apo dhe për disa gjoba lidhur me subjektet që ndotin ambientin. Një situatë tjetër perceptimi shpërfaqet në qytetin e Elbasanit: fëmijët dhe të rinjtë u shprehën se kishin dëgjuar për këtë ligj, sidomos gjatë aktiviteteve të organizuara nga Zëri 16 +, por nuk disponojnë njohuri mbi përmbajtjen në detaj të ligjit, aspekte të tjera teknike, si dhe nënvizuan faktin që mendimi i tyre nuk ishte marrë përpara miratimit të ligjit.

## ***III. Aktivitetet që organizohen nga fëmijët dhe të rinjtë për ndryshimet klimatike***

Fëmijët dhe të rinjtë përmendën dhe sqaruan një sërë aktiviteteve, që kryesisht lidheshin me mbrojtjen e mjedisit, të realizuara në shkollat e tyre, si psh:

- Aktivitete informuese dhe ndërgjegjëse si pjesë e Zërit 16 +.
- Krijimi i hapësirave dhe mjeteve për mbledhjen e plastikës (shkolla Vasil Ziu).
- Pjesëmarrja në fushata ndërgjegjëse për mbrojtjen e lumenjve RiverCleanUp për lumin e Ishmit.
- Realizimi i aktiviteteve *peer leaders*, ku fëmijët dhe të rinjtë ndërgjegjësonin të rinjtë e tjerë për njohuritë e marra.
- Aktivitete ndërgjegjëse përmes vizatimeve, marshimeve, broshurave apo dhe aspekteve të tjera teatrale.
- Zhvillimi i testeve për nivelin e ndotjes së ajrit dhe aktivitete ndërgjegjëse për këtë fakt (qytetin e Elbasanit).
- Aktivitete të realizuara në ditët simbolike (më së shumti 22 Prill dita e Tokës).
- Aktiviteti '*Klasa më e pastër*' e ngritur nga Drejtoria e Shkollës, si iniciativë e qeverisë së nxënësve.

Gjatë diskutimit me fëmijët dhe të rinjtë, ata pohuan se këto aktivitete herë iniciohen nga Drejtoria apo Senati i Shkollës, e herë të tjera nga vetë fëmijët dhe të rinjtë. Ata pohojnë se nuk janë në dijeni të një plani aktiviteteve gjatë gjithë vitit kalendarik që u vendoset në dispozicion nga shkolla ku ata mësojnë. Gjithsesi, aktivitetet janë dinamike dhe të shumta lidhur me çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

#### ***IV. Pritshmëritë nga aktorët e tjerë***

##### *a. Nga vetë fëmijët dhe të rinjtë*

Një mendim i përsëritur me doza mjaft motivuese u vu re nga fëmijët dhe të rinjtë në dy qytetet. Ata theksuan shumë herë që janë vetë fëmijët dhe të rinjtë që duhet ta promovojnë këtë kauzë, jo duke pritur gjithmonë që dikush të bëjë diçka për ta. Një nxënëse cilësoi rëndësinë duke ndarë edhe praktikën e saj, lidhur me shpërndarjen e informacioneve dhe rolit ndërgjegjësues që vetë fëmijët mund të kenë te prindërit e tyre. Njëkohësisht, roli i prindërve si mbështetës në këtë kauzë, u cilësua po njësoj i rëndësishëm. Gjatë gjithë realizimit të fokus grupit u vu re se fëmijët dhe të rinjtë theksuan rolin dhe angazhimin e tyre në nivel individual si thelbësor, për ndryshimin e kauzës në fjalë: “*Nëse secili prej nesh bën detyrat e oazit të vet, është një fillim i mbarë i këtij misioni.*” (Anais nga Durrësi) Cilësohet motivues ky nivel perceptimi i shprehur nga vetë të rinjtë, duke e vendosur veten e tyre në lidhje direkte me nevojën e përmirësimit të ndryshimeve klimatike.

##### *b. Nga shkolla*

Duke u orientuar gjatë diskutimeve, fëmijët dhe të rinjtë evidentuan se:

- Shkolla duhet të luajë një rol më të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm lidhur me zhvillimin e këtyre aktiviteteve, një plan aktiviteteve i miratuar që në fillim të vitit mësimor, do t'i shërbente këtij qëllimi.
- Ndryshimi i kurrikulave, duke përfshirë më shumë informacion dhe vëmendje për ndryshimet klimatike. Shumica e lëndëve si Biologjia, Gjeografia, Edukimi Qytetar ofrojnë vetëm disa paragrafë me informacion të përgjithshëm e të përciptë lidhur me këtë

problematikë. Fëmijët dhe të rinjtë e sollën në vëmendje shpeshherë këtë fakt si moment të rëndësishëm të adresimit të pritshmërive të tyre ndaj shkollës.

*c. Nga bashkia e qytetit*

Të vendosur në rolin e të qenit Kryetar i Bashkisë së Qytetit të tyre, fëmijët dhe të rinjtë evidentuan menjëherë në mënyrë të natyrshme, disa propozime që synonin përmirësimin e shumë aspekteve të lidhura me jetesën e tyre të përditshme si psh:

- Shtimi i koshave të mbeturinave.
- Menaxhimi i përgjegjshëm për ndërtimet e ardhshme.
- Rritja e buxhetit për aspektet mjedisore dhe ndryshimet klimatike.
- Ndërhyrje në Parkun e Elbasanit.
- Rritja e gjobave të vendosura nga pushteti vendor për ‘dënimin’ e qytetarëve dhe subjekteve që ndosin mjedisin.
- Fuqizimi i Këshillave Rinore të ngritura pranë Këshillave Bashkiakë drejt orientimit të kësaj kauze të përbashkët.

Fëmijët dhe të rinjtë e shohin rolin e Bashkisë si jo të mjaftueshëm në parandalimin dhe përmirësimin e ndryshimeve klimatike dhe aspekteve të tjera mjedisore në qytetin e tyre.

## **6. VNDF lidhur me ndryshimet klimatike në Shqipëri**

Fokusi i vlerësimit të këtij raporti do të jetë mbi ligjin 155/2020 dhe aktet nënligjore të miratuara, apo që pritet të miratohen, me qëllim evidentimin e përputhshmërisë së tyre me detyrimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në këtë seksion do të pasqyrohet edhe ballafaqimi ndërmjet perceptimit të fëmijëve apo aktorëve të tjerë të interesuar, lidhur me pritshmëritë e tyre në raport me detyrimet që kuadri ligjor duhet të marrë përsipër, për të garantuar një standard të lartë të respektimit të të drejtave të fëmijëve në këtë fushë specifike, siç janë ndryshimet klimatike.

Pavarësisht disa rregullave dhe linjave kryesore mbi të cilat ndërtohet çdo VNDF, në hartimin e secilit prej tyre ka një proces vendimmarrës lidhur me çështjet që do të trajtohen, të drejtat e



fëmijëve që do të merren në konsideratë si të prezumuara se ndikohen dhe nëse analiza do të fokusohet në ndikimin negativ apo pozitiv që ka akti, apo praktika e marrë në konsideratë. Nisur nga fakti që ligji 155/2020 ka si objektiv marrjen e masave për të ulur efektet e ndryshimeve klimatike, por dhe për të frenuar këto ndryshime, atëherë edhe analiza që do t’ju bëhet të drejtave të fëmijëve do të jetë në aspektin se sa ky ligj, arrin të garantojë dhe të mbrojë të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve të mbrojtur posaçërisht nga aktet ndërkombëtare, pra sa ky ligj e përmbush objektivin e tij në një kategori të veçantë të qytetarëve shqiptarë, siç janë fëmijët dhe të rinjtë.

## ***Struktura e VNDF***

### *1. Përshkrim i shkurtër i objektivit të aktit juridik*

Referuar relacionit për projektligjin “Për ndryshimet klimatike”, dokumenti që Këshilli i Ministrave, si institucioni që ka ushtruar nismën legjislative i ka paraqitur Kuvendit të Republikës për të argumentuar nevojën e miratimit të ligjit, përcakton se objektivi i këtij akti, është krijimi i bazës ligjore për integrimin e politikave dhe për masa efektive që mundësojnë:

- a) plotësimin e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë ndaj Konventës për arritjen e objektivit final të saj, përmes nxitjes së reduktimit të shkarkimeve GES dhe ruajtjes dhe rritjes së përthithësve e rezervuarëve të vendit;
- b) përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar dhe/ose lokal;
- c) evidentimin e arritjeve të vendit në këto drejtime duke përdorur metodologji sipas modeleve të Konventës dhe të BE-së.<sup>28</sup> Ligji krijon themelet juridike dhe kuadrin institucional për plotësimin e detyrimeve të vendit ndaj Konventës, vendimeve të konferencave të palëve, por edhe për përafrimin me *acquis*-n përkatëse për klimën.

---

<sup>28</sup> Relacioni për projektligjin “Për ndryshimet klimatike”. Dokumentin e plotë mund ta gjeni në: <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190830110704RELACION%20-%20NDRYSHIMET%20KLIMATIKE.pdf>

Ligji nuk ka përcaktime konkrete lidhur me qasjen që ai ka kundrejt fëmijëve në mënyrë të veçantë dhe specifike. Sigurisht që nuk mund të pretendohet që i tërë përshkrimi i ligjit të fokusohet te të drejtat e fëmijëve, por përfshirja e ndikimit të ligjit të fëmijët duke mbrojtur interesin më të lartë të tyre qoftë në parimet e ligjit, apo në përmbajtje të tij, do t'i hapte rrugë miratimit të legjislacionit dytësor për detajime më specifike me këtë fokus.

### 2. Numri i fëmijëve dhe të rinjve që ndikohen

Në mënyrë të përgjithshme ligji 155/2020, “Për ndryshimet klimatike” është një ligj kuadër dhe si rezultat, ai ka ndikim tek të gjithë fëmijët dhe të rinjtë që jetojnë në Republikën e Shqipërisë, qofshin këta shtetas shqiptar apo jo.

Në mënyrë më specifike, duke qenë se objektivi i ligjit është marrja e masave që do të mund të ndikojnë në ndryshimet klimatike dhe ngrohjen globale, atëherë ndikimi do të jetë më i prekshëm në ato zona të cilat rezultojnë më të rrezikuara nga pasojat e këtyre fenomeneve. Konkretisht, këtu bëjnë pjesë: fëmijët dhe të rinjtë që jetojnë në zona industriale me një nivel të lartë të gazrave serë, që në rast të zbatimit të masave të ligjit, pritet që të ulen; fëmijët dhe të rinjtë që jetojnë në zona bregdetare; po ashtu në zonat ku ka një pakësim të burimeve hidrike; përmbytje; rrëshqitje të dherave etj...

Një kategori tjetër fëmijësh dhe të rinjsh të cilët ndikohen në mënyrë të posaçme nga ky ligj, janë fëmijët e angazhuar në çështje mjedisore, apo çështje të mbrojtjes së të drejtave të tyre, të cilët do të përfshihen drejtpërdrejtë në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në ligj. Nga fokus grupet e realizuara në funksion të këtij raporti studimor, rezultoi se ishin pikërisht fëmijët e angazhuar me Zërin 16 + të menaxhuar dhe mbështetur nga Save the Children Albania që jo vetëm qasnin njohuritë dhe zhvillimet e fundit mbi ndryshimet klimatike, por edhe shërbenin si “peer leaders educators” duke informuar, motivuar edhe fëmijët e të rinjtë e tjerë.

### 3. Aktorët dhe autoritetet e përfshira

Vlerësimi i autoriteteve që kanë kompetencë të angazhohen për zbatimin e detyrimeve të ligjit dhe specifikisht në raport me detyrimet që ky ligj sjell për fëmijët është bërë mbi bazën e vlerësimit të

kuadrit ligjor, por veçanërisht edhe të strategjive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.<sup>29</sup> Autoritetet e përfshira në nivel politikëbërje për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, duke pasur dhe në fokus të drejtat e fëmijëve, janë përkatësisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Ndërkohë për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, është e nevojshme që të përfshihen një sërë aktorësh në nivel lokal apo qendror, qofshin këta publik apo privat, ku mund të përmendim: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Instituti i Shëndetit Publik, Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Njësitë e Qeverisjes Vendore, Organizatat e Shoqërisë Civile, etj.

Në kuadër të kompetencave që AP ka përsa i përket respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në vend në përgjithësi dhe të të drejtave të fëmijëve në veçanti, përfshirja e këtij institucioni në mënyrë proaktive, është thelbësore në kuadër të monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor për ndryshimet klimatike, por dhe veçanërisht përsa i përket masave institucionale konkrete që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit, edukimit dhe advokimit në këtë fushë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe edukimi apo fushatat advokuese në realitetet e vogla rajonale. Kështu, ekzistenca e Këshillave Rinorë të ngritur pranë Këshillave të Qarkut apo Këshillave Bashkiak do të ndihmonte mjaft mirë si një strukturë specifike për fëmijët dhe të rinjtë në raport me kauzën e ndryshimeve klimatike.

#### *4. Burimi i informacionit për vlerësimin*

Raporti i Vlerësimit është i mbështetur në Modelin e VNDF të hartuar nga UNICEF, në dokumente të ngjashme të hartuar nga Save the Children, në studime shkencore lidhur me rëndësinë e VNDF dhe mënyrën e hartimit të tyre, studime për ndryshimet klimatike, si dhe

---

<sup>29</sup> Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit, 2019; Ministria e Shëndetësisë dhe Punëve Sociale, “Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026”, [https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit\\_Qershor-2019\\_-1.pdf](https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit_Qershor-2019_-1.pdf).

kuadrin juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, i detyrueshëm në Republikën e Shqipërisë për fushën e raportit.

Duke ndjekur linjën ndërkombëtare dhe atë evropiane të modeleve të VNDF, do të ishte me vend që Strategjia Shqiptare për Ndryshimet Klimatike dhe Plani i Veprimit ta përfshinte këtë mekanizëm si pjesë të rëndësishme në përmbajtjen e tyre për të koordinuar kështu një linjë koherente edhe me aktet nënligjore që priten të miratohen.

### ***5. Cilat të drejta të fëmijëve ndikohen nga ligji për ndryshimet klimatike?***

Thelbi i hartimit të një Vlerësimi të Ndikimit të Drejtave të Fëmijëve në një fushë të caktuar, ka për objektiv të tij analizën e të drejtave të fëmijëve që garantojnë nga Konventa Kuadër për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, duke evidentuar nëse akti, apo zbatueshmëria e tij në të ardhmen, është në gjendje që të prodhojë ndikim pozitiv apo negativ, të drejtpërdrejtë apo tërthortë, mbi këto të drejta.

Duke e konsideruar këtë si pjesë thelbësore të raportit, në vijim listohen të drejtat e fëmijëve që vlerësohet se ndikohen nga ligji për ndryshimet klimatike dhe zbatimin e tij, si dhe një vlerësim për shtrirjen e këtij ndikimi.

- *Neni 2 i KDF*; Konventa zbatohet tek të gjithë fëmijët, pa diskriminim, pavarësisht etnisë, gjinisë, fesë, gjuhës, aftësive apo çdo gjendje tjetër, pavarësisht asaj që thonë apo bëjnë dhe pavarësisht historikut familjar. Ligji nuk ka parashikime konkrete lidhur me zbatimin e tij ndaj fëmijëve, dhe aq më tepër, zbatimin e parashikimeve të tij nuk paraqet element të diskriminimit. Konsiderohet se kjo e drejtë respektohet nga ligji.
- *Neni 3 i KDF*; Interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë prioriteti kryesor në të gjitha vendimet dhe veprimet që prekin fëmijët. Qëllimi i KDF për këtë parashikim nuk ka të bëjë me përfitimin nga fëmijët i të drejtave që u njihen dhe zbatohen edhe grupeve të tjera të shoqërisë, por ka të bëjë me nevojën që çdo vendimmarrje, praktikë administrative, politike shtetërore duhet që të vlerësojë posaçërisht se cili është interesi më i lartë i fëmijës dhe cilat janë hapat kryesorë për ta garantuar këtë interes. Nga analiza e dispozitave të ligjit, nuk rezulton që të jetë bërë një vlerësim i posaçëm i interesit më të lartë të fëmijës.

➤ *Neni 4 i KDF;* Qeveritë duhet të bëjnë gjithçka që mundën për të siguruar që çdo fëmijë të mund të gëzojë të drejtat e tij, duke krijuar sisteme dhe miratuar ligje që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Kjo e drejtë rregullohet nga një dispozitë ndihmëse që synon marrjen e masave nga ana e autoriteteve publike për të garantuar të drejtat e fëmijëve. Nëse ligji për ndryshimet klimatike me objektivin e tij parësor për të ulur prodhimin e gazrave serë, por edhe për të garantuar një përshtatshmëri më të lartë me ndryshimet klimatike, do të ketë një zbatueshmëri të lartë, ai ka mundësitë që të japë një kontribut të rëndësishëm në gëzimin e të drejtave të fëmijëve, duke kufizuar, apo minimizuar pasojat negative të fenomenit të ndryshimeve klimatike.

➤ *Neni 6 i KDF;* Çdo fëmijë ka të drejtën e jetës. Qeveritë duhet të bëjnë gjithçka që mundën për të siguruar që fëmijët të mbijetojnë dhe të zhvillohen në potencialin e tyre të plotë. Vlerësohet se ndryshimet klimatike kanë një ndikim shumë të lartë në jetën e fëmijëve, në cilësinë e saj, por edhe kohëzgjatjen e saj. Fatkeqësitë natyrore që vijnë për shkak të ndryshimeve klimatike, si përmbytje, zjarre, rrëshkitje dherash etj., kanë një rrezik të shtuar për kategori të veçanta të cilat janë edhe më të rrezikuara nga mundësia për të humbur jetën.

Në zbatim të ligjit, një nga angazhimet e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, është hartimi i raportit analitik mbi efektet e ndryshimeve klimaterike dhe të mjedisit të fëmijët në Shqipëri, për të informuar hartimin e planit kombëtar dhe atyre vendore mbi emergjencat civile. Po ashtu do të bëhet adresimi i efekteve të ndryshimeve klimaterike dhe të mjedisit të fëmijët gjatë hartimit të planit kombëtar dhe ato vendore të emergjencave civile, adresimi i efekteve të ndryshimeve klimatike dhe të mjedisit të fëmijët gjatë hartimit të planit kombëtar dhe atyre vendor të emergjencave civile. Përfshirja e këtyre dokumenteve në materialet mbi të cilat do të mbështetet Plani Kombëtar dhe planet vendore për emergjencat civile, është një hap pozitiv dhe që vlerësohet se do të ketë ndikim real në garantimin e të drejtës së fëmijëve për jetën.

➤ *Neni 12 i KDF;* Çdo fëmijë ka të drejtë të shprehë pikëpamjet, ndjenjat dhe dëshirat e tij për të gjitha çështjet që i prekin, dhe të merren parasysh dhe të merren seriozisht pikëpamjet e tij. Në

ditët e sotme nuk ekziston një fenomen i tillë, si një politikë neutrale ndaj fëmijëve,<sup>30</sup> kjo është aq më shumë e vërtetë dhe e ndjeshme në politikat që kanë lidhje me ndryshimet klimatike, duke qenë se fëmijët janë grupimi i popullsisë më i prekur prej tyre. Pavarësisht kësaj, fëmijët vijojnë të anashkalohen gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave në fushën e ndryshimeve klimatike. Kjo u bë mjaft e qartë nga diskutimet me fokus grupet, por është e qartë edhe nga analiza e ligjit dhe dokumenteve strategjike. Asnjë prej tyre nuk parashikon mekanizma që mundësojnë marrjen në konsideratë të mendimit të fëmijëve lidhur me këto çështje. Edhe gjatë fokus grupeve të zhvilluara, fëmijët pohonin në mënyrë të vazhdueshme se nuk kishin dërguar për ndonjë masë (vendim) të qeverisë apo aq më pak të kryetarit të bashkisë së qytetit të tyre, për të konkretizuar ligjin për ndryshimet klimatike, gjë që sipas tyre e bën edhe më abstrakt zbatimin e ligjit në realitetet e tyre. Komiteti vlerëson që *“thjesht dëgjimi i fëmijës është i pamjaftueshëm; pikëpamjet e fëmijës duhet të merren seriozisht në konsideratë në ato raste kur fëmija është i aftë të formojë pikëpamjet e veta.”*<sup>31</sup>

- *Neni 13 i KDF*; Çdo fëmijë duhet të jetë i lirë të shprehë mendimet dhe opinionet e tij dhe të ketë akses në çdo lloj informacioni, për sa kohë që është brenda ligjit. Pjesëmarrja publike në fushën e ndryshimeve klimatike, rregullohet nga neni 28 i ligjit, duke ju lënë detyë ministrive kompetente që gjatë përgatitjes apo përditësimit të legjislacionit dhe strategjive të tyre në lidhje me klimën, të garantojnë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, sektorin privat dhe publikun, sipas përcaktimeve të Konventës së Aarhusit dhe legjislacionit përkatës kombëtar. Ligji nuk parashikon kategori të veçanta të cilat shpëtohen nga pjesa e përgjithshme e publikut. Kjo nuk bëhet as nga Konventa e Aarhusit, që garanton pjesëmarrjen e publikut në proceset mjedisore dhe as nga kuadri ligjor në këtë fushë. Nga analiza e perceptimeve të fëmijëve dhe të rinjve, pjesë e fokus grupeve, u evidentua se fëmijët nuk e kanë ushtruar të drejtën e tyre për t'u marrë në konsideratë, për të dhënë mendimet e tyre dhe për t'u dëgjuar. Ndryshimet klimatike janë një çështje që i prek fëmijët drejtpërdrejtë dhe ky grup duhet të jetë në vëmendje të

---

<sup>30</sup> *The Climate Crisis is a Child Rights Crisis: Introducing the Children's Climate Risk Index*. New York: United Nations Children's Fund (UNICEF), 2021.

<sup>31</sup> Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijës, GC12, pg. 28.

veçantë. Pikëpamjet e tij duhet të jenë pjesë e hartimit të akteve nënligjore dhe të strategjive në këtë fushë. Vihen re thjesht disa aktivitete apo nisma sporadike, të cilat nuk janë gjithpërfshirëse dhe aq më pak të mjaftueshme për të përmbushur këtë detyrim.

- *Neni 15 i KDF*; Çdo fëmijë ka të drejtë të takohet me fëmijë të tjerë dhe të bashkohet me grupe dhe organizata, për sa kohë që kjo nuk i pengon njerëzit e tjerë të gëzojnë të drejtat e tyre. Këtu rezulton një qasje praktike pozitive, duke qenë se shumica e fëmijëve pjesë e fokus grupeve ishin të angazhuar në Zëri 16 +, të menaxhuar dhe mbështetur nga Save the Children Albania. Gjithsesi, fokusi dhe ky angazhim s'është me dimension specifik ndryshimet klimatike, por pasja në vëmendje e një serë aktiviteteve për ndryshimet klimatike dhe mjedisin, mbetet sërisht një element premtues. Është e nevojshme që nëpërmjet programeve të posaçme të lehtësohet procesi i bashkimit të fëmijëve dhe të rinjve në grupime dhe organizata me fokus ndryshimet klimatike. Për këtë të drejtë ligji nuk ka ndikim negativ, por për t'u konsideruar se ligji garanton përmbushjen e kësaj të drejte, është e nevojshme që të merren nisma aktive. Kjo mund të plotësohet me anë të akteve nënligjore, të strategjive, apo me anë të planeve të posaçme për krijimin e grupeve në shkolla, apo veprimtari të tjera që do të ndihmonin fëmijët të bashkoheshin me njëri-tjetrin, duke pasur në fokus ndryshimet klimatike.
- *Neni 17 i KDF*; Çdo fëmijë ka të drejtën e informacionit të besueshëm nga burime të ndryshme dhe qeveritë duhet të inkurajojnë mediat që të ofrojnë informacion që fëmijët mund ta kuptojnë. Ligji parashikon masa për rritjen e edukimit qytetar dhe arsimor, nëpërmjet përfshirjes së programeve të posaçme në sistemin arsimor, si dhe marrjen e masave për të realizuar informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, nëpërmjet fushatave të informimit për të sensibilizuar e ndërgjegjësuar popullatën për efektet negative të ndryshimeve klimatike, për masat konkrete që mund të marrin për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Ligji e parashikon si një detyrim konkret bashkëpunimin me publikun, por rregullimin e lë në kompetencë të akteve specifike nënligjore në këtë fushë, duke qenë se vetë nuk përmban asnjë specifikim konkret në këtë drejtim. Në kuptim të përmbushjes së detyrimit në raport me këtë të drejtë, ligji vlerësohet të ketë ndikim pozitiv, pasi nëse përmbushen detyrimet e parashikuara në ligj, do të ketë një rritje të informacionit të disponueshëm për fëmijët në fushën e ndryshimeve





klimatike dhe kjo nëpërmjet programeve arsimore apo forma të tjera të besueshme të shpërndarjes së informacionit.

Qeveritë duhet të ndihmojnë në mbrojtjen e fëmijëve. Gjatë fokus grupeve të zhvilluara, fëmijët theksuan faktin se burimi më i shpeshtë i informacionit ka qenë shkolla si dhe Save the Children Albania në kuadër të angazhimit të Zëri 16+. Asnjë aktivitet nuk ka qenë i mbështetur apo i inicuar nga Drejtoria Arsimore apo Ministria e Arsimit.

*Neni 28 i KDF;* Çdo fëmijë ka të drejtën e arsimimit. Arsimi fillor duhet të jetë falas dhe forma të ndryshme të arsimit të mesëm duhet të jenë të disponueshme për çdo fëmijë. Në të njëjtën linjë me sa u evidentua më sipër, ligji vlerësohet se ka një ndikim pozitiv, duke qenë se parashikon përfshirjen në programet arsimore të informacionit për ndryshimet klimatike. Si një ligj që kërkon bashkëpunimin e gjerë dhe mbështetjen e publikut, sigurisht që pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje është pjesë e rëndësishme e procesit. Ligji e parashikon si një detyrim konkret, por rregullimin e lë në kompetencë të akteve specifike ligjore në këtë fushë.

Në këtë aspekt, fëmijët dhe të rinjtë e vendosin si një të drejtë të rëndësishme që ndikohet nga ndryshimet klimatike, kjo sidomos referuar zonave rurale, ku ndryshimet klimatike ndikojnë drejtpërdrejt në transportin e fëmijëve në shkollat e tyre, duke krijuar pengesa për arsimimin e plotë dhe gjithpëfshirës.

- *Neni 24 i KDF;* Çdo fëmijë ka të drejtën për shëndetin më të mirë të mundshëm. Qeveritë duhet të ofrojnë kujdes shëndetësor me cilësi të mirë, ujë të pastër, ushqim me vlera ushqyese dhe një mjedis të pastër, si dhe edukim mbi shëndetin dhe mirëqenien, në mënyrë që fëmijët të mund të qendrojnë të shëndetshëm. Kjo dispozitë e KDF lidh në mënyrë të drejtëpërdrejtë të drejtën e fëmijëve për një shëndet të mirë me detyrimin e shtetit për të garantuar një mjedis të pastër. Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve në vitin 2013, evidentoi rëndësinë e mjedisit për shëndetin e fëmijëve, si dhe nevojën për të adresuar ndryshimet klimatike, duke ju referuar atyre si: “*kërcënimi më i madh për shëndetin e fëmijëve*”<sup>32</sup>

---

<sup>32</sup> ENOC Synthesis Report, *Children’s Rights and Climate Justice*, përgatitur nga Aoife Daly, Laura Lundy, University College Cork, Maj 2022.



Vendet më të pasura duhet të ndihmojnë vendet më të varfra t'i arrijnë këto standarde. Të gjitha sa parashikohen në këtë nen të KDF, cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale, e cila rrit sëmundshmëritë e ndryshme; ul aksesin në burimet ujore të pijshme; ul mundësinë për ushqim të shëndetshëm dhe me vlera ushqyese; si dhe ndikon në dëmtimin e përgjithshëm të treguesve mjedisorë. Për këtë arsye, vetë miratimi i ligjit për ndryshimet klimatike, është një kontribues në zvogëlimin e efekteve negative që vijnë prej tyre, duke ndihmuar në përmbushjen e detyrimeve të konventës për këtë nen. Megjithatë, parashikimet e ligjit duhet të adresonin më specifikisht nevojat e fëmijëve, duke qenë se kjo kategori e popullsisë është mbartësja kryesore e sëmundshmërisë së lidhur me ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike gjithashtu mund të dëmtojnë ose prishin aksesin në shërbimet dhe klinikat thelbësore shëndetësore.<sup>33</sup> Për sa kohë në ligj këto rregullime specifike mungojnë, konsiderohet se ky nen i KDF nuk ka nivelin e duhur të mbrojtjes. Gjithsesi, ligji ka hedhur themelet e garancive që mund të plotësohen me parashikime në aktet përkatëse nënligjore.

*Neni 29 i KDF;* Arsimi duhet të zhvillojë plotësisht personalitetin, talentin dhe aftësitë e çdo fëmije. Ai duhet të inkurajojë respektin e fëmijës për të drejtat e njeriut, respektin për prindërit e tyre, kulturat e tyre dhe të tjera, si edhe mjedisin natyror.

E drejta e fëmijëve për edukim ndikohet nga ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale, pasi fëmijët mund të detyrohen të qendrojnë larg shkollës për shkak të fatkeqësive të lidhura me ndryshimet klimatike, të tilla si përmytjet, stuhitë ose thatësitat. Ligji nuk parashikon masa konkrete për adresimin e kësaj kategorie problemesh, por kjo mund të jetë objekt i rregullimeve të tjera ligjore, siç është psh. ligji për emergjencat civile, apo nga parashikimet e strategjive vendore për përballimin e situatave të jashtëzakonshme.

Neni 26 i ligjit rregullon edukimin dhe trajnimin, duke parashikuar detyrimin e ministrisë që të bashkëpunojë me ministrinë përgjegjëse për arsimin për hartimin dhe zbatimin e programeve në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike për të gjitha nivelet e arsimit. Ministria bashkëpunon

---

<sup>33</sup> *The Climate Crisis is a Child Rights Crisis:: Introducing the Children's Climate Risk Index.* New York: United Nations Children's Fund (UNICEF), 2021.

sa herë që i kërkohet nga ministria përgjegjëse për arsimin lidhur me përmbajtjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera didaktike dhe nxit pjesëmarrjen e institucioneve arsimore të të gjitha niveleve në iniciativa për kërkime shkencore, edukim dhe trajnim në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Marrja e masave në këtë drejtim do të ndihmonte në përmbushjen e një prej problematikave kryesore të rezultuar nga fokus grupet me fëmijët, mungesa e theksuar e njohurive të thelluara në kurrikulat mësimore lidhur me ndryshimet klimatike. Lidhur me garantimin e kësaj të drejte në kurrikulat shqiptare është përfshirë: *kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin*. Shkollat përgatitin nxënësit me kapacitete për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen për zhvillimin vetjak, përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Shkolla i ballafaqon nxënësit me problemet ekologjike, për t'i ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit.<sup>34</sup>

E drejta e fëmijëve për informim gjen rregullim edhe në nenin 27 të ligjit, i cili parashikon detyrimin për shpërndarjen e informacionit dhe të ndërgjegjësimit publik në lidhje me efektet e ndryshimeve klimatike. Mënyra kryesore e përmbushjes së këtij detyrimi është nëpërmjet fushatave të informimit për të sensibilizuar e ndërgjegjësuar popullatën për efektet negative të ndryshimeve klimatike. Në pritje të akteve nënligjore që do të detajojnë metodologjinë se si do të përmbushen detyrimet e parashikuara në nenet 26 dhe 27 është ende herët për të bërë një vlerësim të zbatueshmërisë, por parashikimi ligjor është jo vetëm në përputhje me KDF, por edhe garanton në përmbushjen e këtyre të drejtave. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve shprehet se respektimi për një mjedis natyror duhet të mësohet nga fëmijët në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.<sup>35</sup>

- *Neni 31 i KDF*: Çdo fëmijë ka të drejtë të pushojë, të luajë dhe të marrë pjesë në një gamë të gjerë aktiviteteve kulturore dhe artistike. Ndryshimet klimatike kërcënojnë aftësinë e fëmijëve për të hyrë në hapësira të sigurta për rekreacion dhe lojë, duke përfshirë shkatërrimin ose dëmtimin e shkollave, si dhe hapësirave të komunitetit. Masat e parashikuara në ligj për të ndaluar efektet e

---

<sup>34</sup> MASR (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), “Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm dhe të Lartë”, <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Kurrikula-Berthame-AML.pdf>.

<sup>35</sup> Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve i OKB-së, (2001) Koment i përgjithshëm nr.1: *Synimet e edukimit*, pg.13.

ndryshimeve klimatike dhe për të ndihmuar popullsinë të përshtatet me to gradualisht, vlerësohet se kanë ndikim dhe në përmbushjen e këtij detyrimi të Konventës.

- *Neni 12/2 i KDF*; Fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar. Kjo dispozitë rregullon aksesin në drejtësi të fëmijëve, në kuptimin e adresimit të çështjeve të lidhura me ndryshimet klimatike përpara organeve administrative dhe gjyqësore, qofshin këto kombëtare apo ndërkombëtare. Një aspekt i ri i aktivizmit mjedisor, janë pikërisht çështjet gjyqësore të cilat në mjaft raste janë iniciuar nga grupe fëmijësh apo të rinjsh, duke pretenduar cenimin e të drejtave të tyre në raport me mjedisin dhe ndalimin e ndryshimeve klimatike. Legjislacioni shqiptar nuk ka asnjë parashikim për këtë pikë dhe praktika në vend është ende e panjohur me raste të tilla. Rastet e litigimit strategjik kanë një rol kyç jo vetëm në zgjidhjen konkrete të një çështjeje që adresohet në gjykatë, por edhe për efektin ndërgjegjësues dhe informues kundrejt publikut. Për momentin dispozitat procedurale shqiptare nuk u japin mundësinë fëmijëve që të adresojnë vetë çështje në gjykatë, por vetëm me anë të kujdestarëve të tyre ligjorë. Rritja e njohurive të fëmijëve në këtë fushë, me anë të praktikave më të mira ndërkombëtare, të fushatave të aktivizmit shoqëror dhe institucional, do të mund të sillte një aktivizëm të tillë dhe në Shqipëri.

## **7. Gjetjet dhe Rekomandimet lidhur me mbrojtjen të drejtave të fëmijëve nga ndryshimet klimatike**

Në një nivel të përgjithshëm marrja e masave për uljen e shkarkimeve të gazrave me efekt serë dhe përshpejtimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, pritet që të ketë ndikime pozitive në jetën e fëmijëve dhe gëzimin e të drejtave të tyre sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Nga ndryshimet do të përfitojnë brezat që do të pasojnë, kështu që ato vlerësohet se janë në interesin më të mirë të fëmijës.

Në një analizë më të detajuar, vlen të theksohet se kuadri ligjor i miratuar është ende i paplotë dhe si rezultat, në një pjesë të madhe të tij i pazbatueshëm. Me përjashtim të akteve nënligjore të

miratuara më herët, lidhur me kufizimin e emetimit të gazrave serë, aktet e tjera që do të plotësojnë kuadrin dhe do të bëjnë ligjin efektiv do të miratohen brenda 4 vitesh nga hyrja në fuqi e ligjit, duke ulur në këtë mënyrë ndjeshëm efektivitetin e ligjit. Konstatohet që angazhimet ligjore janë më shumë retorike, në vend që të përfshijnë angazhime praktike, një fenomen ky jo vetëm shqiptar, pasi është konstatuar edhe në shumë vende të tjera.<sup>36</sup>

Mungesa e një VNDF nuk është një rast i izoluar për këtë ligj, pasi në vend ky mekanizëm nuk është i përfshirë në procedurat e vendimmarrjes ligjore. Vlerësohet se është e rëndësishme përfshirja e VNDF-së në çdo vendimarrje politike apo ligjore, e cila ndikon në respektimin e të drejtave të fëmijëve, me qëllim që të garantohet parimi i *interesit më të lartë të fëmijës*.

Adresimi i ndryshimeve klimatike duhet të fillojë domosdoshmërisht nga edukimi. Jo vetëm në kuptimin e ngushtë të edukimit të fëmijëve në shkollë, por edhe në shtëpi dhe në komunitet. Vetëm në këtë mënyrë, do të arrihet që fëmijët dhe të rinjtë të aftësohen për të ndërtuar një mënyrë jetese në përputhje me mjedisin, duke dhënë kontributin e tyre aktiv në uljen e rrezikut të ndryshimeve klimatike, por njëkohësisht do të arrihet që fëmijët të kenë mundësi të ushtrojnë efektivisht të drejtat e tyre për t'u bërë pjesë e vendimmarrjes, për t'u dëgjuar, për të kërkuar respektimin e të drejtave të tyre në rrugë administrative dhe gjyqësore.

Përfshirja në kurrikulat mësimore shqiptare e kompetencës për jetën, mjedisin dhe sipërmarrjen, vlerësohet si një arritje pozitive. Pavarësisht kësaj, nga fokus grupet e zhvilluara, u konstatua një mungesë e rezultateve konkrete në njohuritë e fëmijëve në këtë fushë. Pra, në këtë rast është e rëndësishme gjetja e mekanizmave efektiv për realizimin konkret të objektivit të vendosur nga kurrikula dhe zgjerimi i konceptit të edukimit, nëpërmjet përfshirjes dhe të aktorëve të tjerë jashtë shkollës.

Është e rëndësishme të rriten përpjekjet në vend për t'i adresuar çështjet e mjedisit si të lidhura ngushtësisht me çështjet e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre, të garantuara nga Kushtetuta, nga KDF, por edhe nga akte të tjera ndërkombëtare dhe të legjislacionit të brendshëm.

---

<sup>36</sup> ENOC Synthesis Report, *Children's Rights and Climate Justice*, përgatitur nga Aoife Daly, Laura Lundy, University College Cork, Maj 2022.



AVOKATI I POPULLIT



Ndërtimi i kornizës ligjore dhe qasja institucionale duhet që të funksionojnë në mënyrë paralele me qëllim përmirësimit dhe sigurimit të një impakti social të qëndrueshëm. Në këtë dimension, Avokati i Popullit me kompetencat e dhëna nga ligji ka potencialin për të qenë një mekanizëm thelbësor në nivel të përmbushjes së objektivave të ligjit dhe të monitorimit të zbatueshmërisë.

Duhet rritur advokimi në nivel kombëtar, rajonal dhe global për të siguruar respektimin e të drejtës së patjetërsueshme të fëmijëve për një mjedis të shëndetshëm. Kjo mund të arrihet vetëm nga një bashkëpunim, koordinim dhe ndërveprim i të gjithë aktorëve të përfshirë dhe gjithmonë me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve, si zëdhënësit kryesorë të këtyre të drejtave.

Adresimi i problematikave që shkakton ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike, duhet të kenë një analizë të posaçme përse i përket fëmijëve. Si kategori me specifika dhe veçori të ndryshme nga kategoritë e tjera, është thelbësore që masat lehtësuese ndaj tyre të jenë të analizuara dhe të dedikuara posaçërisht.

Fëmijët dhe të rinjtë janë kryesisht të përjashtuar nga proceset e vendimmarrjes publike, pa aftësi votimi dhe me kompetenca të kufizuara për të advokuar për interesat e tyre, përveçse nëpërmjet të rriturve. Prandaj është thelbësore, që veçanërisht për çështje të cilat prekin drejtpërdrejtë dhe thelbësisht të drejtat e tyre, ata të merren në konsideratë seriozisht. Kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet zhvillimit të proceseve administrative të posaçme, të konsultimit dhe të dëgjimit të këtyre grupmoshave.

Përgjegjësia e qeverisë për fëmijët priret të jetë e fragmentuar nëpër departamente dhe agjenci, duke bërë që shpesh të jetë e vështirë, si identifikimi i problemeve ashtu edhe adresimi i duhur tyre. Për këtë është detyrë e organeve të posaçme që mbikqyrin respektimin e të drejtave të fëmijëve që të kontribuojnë në koherencën e politikave dhe në koordinimin e zbatueshmërisë së tyre.

Fëmijët janë përfitues të shërbimeve publike, arsimore, shëndetësore, në kuadër të emergjencave civile, shërbimeve sociale, por nuk kanë mekanizma ankimes të përshtatshëm për ta. Kjo vlen për të gjitha fushat e politikës shtetërore dhe shtrihet edhe për çështje të lidhura me ndryshimet

klimatike, si e tillë ka nevojë për një adresim për të mundësuar garantimin dhe respektimin e të drejtave që KDF dhe legjislacioni shqiptar ju njeh.

Është e rëndësishme që të rritet pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve të të gjitha moshave në çështje që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike. Në kuadër të angazhimit është e nevojshme të përfshihen:

- Seminare të përshtatshme për moshën në mjedise arsimore formale dhe joformale.
- Pyetësore dhe sondazhe.
- Rritje e ndërgjegjësimit për aktivizmin e të rinjve dhe fëmijëve.
- Punë me palët e përfshira që mbështesin fëmijët dhe të rinjtë.
- Nevoja për monitorim të respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Mjedisi, ambienti që na rrethon dhe të gjithë elementët e planetit Tokë, janë pasuri që ne ua lëmë në trashëgim brezave që vijnë. Fëmijët nuk mund të jenë vetëm spektatorë të vendimmarrjeve politike dhe administrative të të rriturve, kur këto vendimmarrje do të shënojnë në mënyrë të përhershme jetët e tyre tani dhe të ardhmen e tyre si të rritur. Lëvizjet e viteve të fundit për përfshirjen e fëmijëve në vendimmarrje të rëndësishme për çështje mjedisore, duhet të marrin vëmendjen e duhur dhe në vendin tonë, duke filluar kjo nga edukimi i fëmijëve që në moshë të vogël për këto problematika.

## 8. Bibliografia

### *Botime të ndryshme*

- ✓ Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, VKM Nr.659, dt.03.11.2021
- ✓ Annual Implementation Report, Energy Community Secretariat, November 2021
- ✓ Child Rights Impact Assessment (CRIA): A review of comparative practice across the UK, Unicef UK, Lisa Payne, qershor 2017
- ✓ ENOC European NetWork of Ombudspersons for Children
- ✓ ENOC Synthesis Report, Children's Rights and Climate Justice, përgatitur nga Aoife Daly, Laura Lundy, University College Cork, Maj 2022
- ✓ Janet Currie and Olivier Deschênes, Children and Climate Change: Introducing the Issue", Children and Climate Change, The future of Children, Vol.26, No.1, spring 2016
- ✓ KAS, "Raport i Fondacionit KAS për klimën në Shqipëri", 2011
- ✓ Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm dhe të Lartë, Ministria e Arsimit dhe Sportit
- ✓ Paula McDiarmid, red., In the Face of Disaster: Children and Climate Change (London: International Save the Children Alliance, 2008
- ✓ Relacion për projektligjin "Për ndryshimet klimatike"
- ✓ Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve (2022-2027), "Të drejtat e fëmijëve në veprim: nga zbatimi i vazhdueshëm tek inovacioni i përbashkët"
- ✓ Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit, 2019
- ✓ Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit, 2019; Ministria e Shëndetësisë dhe Punëve Sociale
- ✓ Strategjia e Ombudsmanit Evropian (2020)
- ✓ The Climate Crisis is a Child Rights Crisis: Introducing the Children's Climate Risk Index. New York: United Nations Children's Fund (UNICEF), 2021
- ✓ Unicef (2010), Child rights toolkit – draft version. Vol.1

### *Akte Juridike*

- ✓ Deklarata për Veprim mbi Fëmijët, të Rinjtë dhe Klimën, Deklaratë Ndërqeveritare e OKB-së, Madrid 2019
- ✓ Konventa e Aarhusit, ose “Konventa për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, Ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000
- ✓ Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, miratuar në Nju Jork më 9 maj 1992, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 1995 dhe ku Republika e Shqipërisë është palë jo e shtojcës I
- ✓ Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin: Nr.7531, datë 11.12.1991
- ✓ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- ✓ Ligj nr.155/2020, “Për ndryshimet klimatike”
- ✓ Ligji 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”
- ✓ Ligjin nr.8454 date 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”
- ✓ Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, ratifikuar me ligjin nr.9590, dt.27.07.2006
- ✓ Protokoll i Kiotos i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike”, miratuar në Kioto më 11 dhjetor 1997, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 30 qershor 2005
- ✓ Rezoluta 48/13, Këshilli për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara, 8.10.2021
- ✓ Traktati për Krijimin e Komunitetit të Energjisë, Ratifikuar me ligjin Nr.9501, dt.03.04.2006
- ✓ VKM nr.348, dt.11.05.2016, “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020”
- ✓ VKM nr.584, dt.28.08.2003, “Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”

### **Burime elektronike**

<https://ennhri.org>

<https://fra.europa.eu>

<https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/crc>





AVOKATI I POPULLIT

[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

[www.energy-community.org](http://www.energy-community.org)

[www.parlament.al](http://www.parlament.al)

[www.savethechildren.net](http://www.savethechildren.net)

[www.savethechildrenalbania.net](http://www.savethechildrenalbania.net)

[www.un.org](http://www.un.org)



## ANEKS



*Ky fokus group zhvillohet në kuadër të projektit rajonal 'Children Stand Up', i zbatuar nga Save the Children Albania. Menaxhimi i të dhënave personale do të realizohet sipas legjislacionit në fuqi, duke u servirur vetëm për qëllime të projektit, në mënyrë specifike hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike në të drejtat e fëmijëve.*

**Zhvilluar sot në datën ora, përmes platformës zoom**

**Qyteti:**

**Numri i pjesëmarrësve**

**Grupmosha**

**Raporti F/M**

**Hyrje**

Në vitin 2020, Kuvendi ynë miratoi ligjin për ndryshimet klimatike. Aktet në zbatim dhe për funksion të këtij ligji nuk kanë dalë ende. Ligji kërkon mekanizma të rinj dhe mbulon disa aspekte të çështjeve klimatike, duke ndjekur kërkesat nga arena ndërkombëtare dhe evropiane. Një nga aspektet me të cilat Save the Children po punon është vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike te të drejtat e fëmijëve. Save the Children është një organizatë ndërkombëtare, e cila punon për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe zhvillimin psiko social të tyre.

Në kuadër të kësaj pune, po hartohet një raport i cili synon që të evidentojë aparatën ligjor si dhe pikëpamjen e fëmijëve lidhur me këtë fushë. Ndaj ju jeni thirrur e përzgjedhur sot, pikërisht për të qenë zëri i parë në këtë kontribut të kërkuar. Në mjediset e shkollave tuaja, shpeshherë fokus i aktiviteteve janë edhe nismat mjedisore. Gjithsesi, ndryshimet klimatike shpeshherë trajtohen nga vetë ne si një dimension pak më i largët global. Ky bashkëbisedim i sotëm, do t'i shërbejë kësaj kauze, ndaj nuk ka pyetje apo përgjigje të gabuara, mirëpresim qasjen tuaj.

## Pyetje cilësore

1. A keni dëgjuar për “ndryshimet klimatike” dhe “ngrohjen globale”?
2. Në një perceptimin tuaj personal, a janë të rëndësishme këto çështje?
3. A e dini që është miratuar një ligj për ndryshimet klimatike (para se unë ta përmendja sot) në vendin tonë?
4. A mund të tregoni për një nismë që keni zhvilluar në shkollën tuaj për ndryshimet klimatike?
5. A jeni informuar nëse shkolla juaj ka një plan aktiviteteve për mjedisin duke përfshirë në mënyrë specifike edhe ndryshimet klimatike?
6. Cilat janë pritshmëritë tuaja nga shkolla ku ju mësoni lidhur me përmiresimin e ndryshimeve klimatike?
7. Cilat janë pritshmëritë tuaja nga bashkia e qytetit ku ju jetoni për ndryshimet klimatike?
8. Në rast se do ishit ju nxënësi i caktuar në shkollën tuaj për të hartuar planin për aktivitetet që lidhen me ndryshimet klimatike, çfarë do të propozonit?
9. A mendoni ju se ka mjaftueshëm informacion të disponueshëm për fëmijët lidhur me “ndryshimet klimatike”?
10. Si fëmijë, ju keni të drejtën për një shëndet të mirë, për një jetesë të mirë, për ujë, ushqim, për të luajtur. A mendoni se ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në këto të drejta tuajat?

11. A mendoni se duhet të dëgjoheni më shumë për këtë çështje dhe përse?
12. Ndonjë koment tjetër, kryesisht lidhur me si e shihni ju ndikimin e ngrohjes globale në jetën tuaj.

**Disa pyetje ‘statistikore’**

13. A mendoni se shkolla duhet të ketë një strukturë të posacme për të menaxhuar aktivitete dhe çështje për ndryshimet klimatike?

PO JO

14. A mendoni se bashkia e qytetit tuaj ka qenë aktive për realizimin e fushatave informuese/ndërgjegjësuese për ndryshimet klimatike dhe se si ndikojnë ato te fëmijët?

PO JO

15. A mendoni se ndryshimet klimatike janë një çështje e rëndësishme e juaja dhe për shkollat ku ju mësoni?

PO JO

16. A mendoni se është detyrë e juaja që të informoni shokët e tjerë të klasës për ligjin për ndryshimet klimatike?

PO JO